



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	08-04-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	2009/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.101/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Arben Mehmeti dhe Eshref Shaban-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.101/2022 të datës 09.02.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.101/2022 e datës 09.02.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.64/2021 i datës 31.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi kandidat për shërbim civil, më datë 23.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 624/22, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.64/2021 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 14.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje referuar SKGJK), ndërsa më datë 10.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1097/22 së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 09.02.2022 me numër protokolli 624/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimin KA.nr.64/2021 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 11.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.02.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 01.03.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 07.12.2021 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin e datës 09.11.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve; Propozimin e datës 09.11.2021 mbi emërimin e kandidatëve të rekomanduar; Raportin e datës 25.10.2021 mbi përgatitjen e listës së ngushtë; Deklaratat e anëtarëve të komisionit lidhur me mos ekzistimin e konfliktit të interesave të datës 25.10.2021; Njoftimin e datës 29.10.2021 për mbajtjen e testimit me shkrim për kandidatet konkurrues; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të kandidatëve; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë; Vendimin e datës 22.10.2021 mbi emërimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatit; Propozimin e datës 22.10.2021 për emërimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Përcaktimin e kritereve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Listën e datës 03.11.2021 të kandidatëve që kanë kaluar/nuk kanë kaluar testin me shkrim për pozitën referent i lartë; Konkursin e jashtëm me numër Nr.03/2021 të datës 20.05.2021 të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Listën mbi vlerësimin nga testi me shkrim dhe me gojë nga anëtarët e komisionit vlerësues për ankuesin; Testin me shkrim të ankuesit së bashku me udhëzuesin për testin me shkrim të datës 01.11.2021; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2021 nga ankuesi së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale; Testin me shkrim të kandidatës së përzgjedhur së bashku me udhëzuesin për testin me shkrim të datës 01.11.2021; Kërkesën për punësim të datës 31.05.2021 të kandidatës së përzgjedhur së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës, atë profesionale dhe listën mbi vlerësimin nga testi me shkrim dhe me gojë nga anëtarët e komisionit vlerësues; Kërkesën për punësim të datës 31.05.2021 të kandidatës së përzgjedhur së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës, atë profesionale dhe listën mbi vlerësimin nga testi me shkrim dhe me gojë nga anëtarët e komisionit vlerësues; Kërkesën për punësim të datës 28.05.2021 të kandidatës së përzgjedhur së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës, atë profesionale dhe listën mbi vlerësimin nga testi me shkrim dhe me gojë nga anëtarët e Komisionit vlerësues; Plotësimin e ankesës së ankuesit të datës 10.02.2022 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër VK.nr.22/2022 të datës 23.03.2022 për vazhdimin e afatit të ankesës nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 23.03.2022; E-maili zyrtar i datës 25.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 20.05.2021 ka shpallur Konkursin e jashtëm me numër Nr.03/2021, për pozitën e punës *Referent i Lartë*, tri (3) pozita në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Konkursi në fjalë ka qenë i

hapur nga data 20.05.2021 deri me datën 03.06.2021, e në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Në listën e ngushtë të datës 21.10.2021, janë përfshirë pesëdhjetë e nëntë (59) kandidatë, kurse bazuar në Njoftimin për përzgjedhje përfundimtare të datës 09.11.2021 të Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si kandidatë të suksesshëm janë shpallur me gjithsej 424.25 pikë, me gjithsej 414.5 pikë dhe me gjithsej 408.75 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me Njoftimin përfundimtar të përzgjedhjes së kandidatëve, me datë 07.12.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.20/2021 të datës 10.12.2021 refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 16.11.2021, me arsyetimin se e gjithë procedura rekrutuese është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimit KA.nr.64/2021 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ankuesi nuk është vlerësuar drejtë në testin me shkrim, janë tejkaluar afatet ligjore lidhur me listën e shkurt dhe vlerësimin e kandidat si dhe vendimi i kundërshtuar është nxjerrë shabllon sikurse për rastet e tjera.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur së organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën *Referent i Lart* në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, ka përcaktuar si kritere themelore: *Diplomë e Fakultetit Juridik dhe Dy (2) vite përvojë pune.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të dëshmimeve për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës të bashkangjitur në dosjen e kandidatëve të përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, vlerësimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil me të cilin theksohet se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathhtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës.*


Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se kandidatja e përzgjedhur e renditur si kandidatja e parë e suksesshme, sipas Diplomës më Nr.5033 të datës 05.10.2017 ka përfunduar me datë 28.06.2017 studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërsa përkitazi me kriterin e përvojës së punës e njëjta sipas Certifikatës të lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës e njëjta nga data 01.03.2018 deri më 01.03.2019 ka përfunduar praktikën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë; kurse sipas Kontratave të punës të datës 01.10.2019, 27.12.2019 dhe 01.07.2020 ka punuar si monitoruese juniore në BIRN-Rrjeti ballkanik i gazetarisë hulumtuese nga data 01.10.2019 deri 30.06.2020 dhe nga 01.07.2020 deri 31.12.2020. Kandidatja e renditur si kandidatja e dytë me e suksesshme sipas Diplomës 5045 të datës 29.12.2017 ka përfunduar me datë 19.09.2017 studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës sipas Certifikatës së datës 04.03.2019 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, e njëjta nga data 12.02.2018 deri më 12.02.2019 ka përfunduar praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, dhe sipas Vërtetimit me nr.31/21 të datës 24.05.2021 nga data 01.01.2017 e tutje, ka kryer punë juridike dhe administrative në Auto shkollën "Ardi", kandidatja e renditur si kandidatja e tretë e suksesshme sipas Diplomës me Nr. 4104 të datës 01.06.2016 e njëjta

me datë 24.11.2015 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", kurse lidhur me përvojën e punës sipas Certifikatës SKPKZBNJ/Nr.03 të datës 01.06.2016, e njëjta nga data 01.10.2015 deri më 31.03.2016 ka përfunduar praktikën vullnetare në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, sipas Vërtetimit Nr.119-64 të datës 30.06.2017, ka qenë e angazhuar si praktikante në Zyrën Ligjore të kabinetit të Kryetarit të Prishtinës nga data 27.06.2016 deri më 30.06.2017, Sipas Marrëveshjeve së lidhur me OJQ/ACDC të datës 14.09.2020 dhe 01.03.2021 ka punuar si bashkëpunëtorë juridike pranë kësaj OJQ-je nga 14.09.2020 deri 28.02.2021 dhe 01.03.2021 deri më 15.06.2021, sipas Letër konfirmimit të datës 04.11.2020 të lëshuar nga Programi i USAID-it Justice Sistem Strengthening Program, e njëjta ka punuar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë për periudhën nga data 01.07.2018 deri 31.03.2019. Rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se kandidatet e përzgjedhur kanë plotësuar kriteret e konkursit, dhe po ashtu Kolegji ka konstatuar së edhe ankuesi ka plotësor kërkesat e arsimit dhe të përvojës së punës, mirëpo bazuar në vlerësimet nga testi me shkrim dhe intervista me gojë kandidatja është vlerësuar me gjithsej 424.25 pikë duke u renditur si kandidatja e parë e suksesshme, kandidatja është vlerësuar gjithsej 414.5 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë e suksesshme, kandidatja është vlerësuar gjithsej 408.75 pikë duke u renditur si kandidatja e tretë, kurse ankuesi nga testimi me shkrim dhe me gojë ka arritur gjithsej 348.75 pikë të përgjithshme dhe është renditur i gjashti (6) në listë, gjegjësisht i njëjti nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur si kandidat i suksesshëm. Andaj, bazuar në faktet e mësipërme, Kolegji ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i emëruar sipas Vendimit Referencë DS-587/2021 të datës 22.10.2021, ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë.*

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ka pas tejkalim të afateve ligjore përkitazi me përgatitjen e listës së shkurtër dhe testim të kandidateve, Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës ka vërejtur se për shkak të numrit tejet të madh të kandidatëve /aplikuarve për pozitën Referent i Lartë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe duke marrë parasysh së në të njëjtin konkurs kanë qenë të shpallura edhe disa pozita të tjera, janë tejkualuar afatet procedurale lidhur me listën e ngushtë dhe testimin e kandidateve, mirëpo Kolegji tejkualimet e tilla nuk i vlerësoj si shkelje esenciale procedurale gjegjësisht sipas gjykimit të Kolegjit kjo e gjetur nuk ka cenuar ligjshmërinë e procesit rekrutues apo të ketë mohuar në ndonjë formë të drejtat e kandidateve në procedurë konkurimi.

Në funksion të shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e testit me shkrim nga ana e Komisionit Përzgjedhës, Kolegji nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit ka konstatuar së përmbajtja e testit me shkrim ka qenë në pajtim me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, dhe se Kolegji nuk ka hasur në ndonjë parregullsi përkitazi me vlerësimin e saktësisë së përgjigjeve të dhëna nga ankuesi, kështu që në këtë kuptim rrjedhë së janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit.

Andaj, bazuar në konstatimet si me lart, Kolegji vlerëson së procedura e rekrutimit për pozitën e Referent i Lartë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, si dhe dispozita e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe si rrjedhoja Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit*



KA.nr.64/2021 të datës 31.12.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.101/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore Gashi-Bajraktari


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

